



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

PËR KTHIMIN PËR PLOTËSIM TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKISË TIRANË TË DEPOZITUARA NGA PARTIA "ALEANCA KUQ E ZI" PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 17.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për kthimin për plotësim të listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në këshillin e Bashkisë Tiranë të depozituara nga Partia "Aleanca Kuq e Zi" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a, neni 67, dhe 6 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia "Aleanca Kuq e Zi", si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:



Nr. 494 i Vendimit

Data 17.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në këshillin e Bashkisë Tiranë të depozituara nga Partia "Aleanca Kuq e Zi" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Partia Aleanca Kuq e Zi, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Partia Aleanca Kuq e Zi, ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore.

Në mbledhjen e datës 17.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për Anëtarë Këshilli të Partisë "Aleanca Kuq e Zi" dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi mangësitë e dokumentacionit si më poshtë:

1. Vërtetim për zotërimin e mandatit në Kuvend sipas sipas nenit 68, pika 2 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar/Listën e zgjedhësve që mbështesin partinë/koalicionin;
2. Numri i kandidatëve është më i vogël se gjysma e numrit të mandateve në këshillin bashkiak, nga 31 ka depozituar 7;
3. Nuk është respektuar kuota gjinore në listën shumemërore Model 10 K;
4. Deklarata e kandidatit për nr. rendor 01;

Në këto kushte KQZ duhet:

Të kthej për plotësim dokumentacionin e kandidimit, për korrigjimin e mangësive të konstatuar nga Partia Aleanca Kuq e Zi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa a, nenin 67, pikat 1, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për Anëtarë Këshilli të Bashkisë Tiranë, të Partisë Aleanca Kuq e Zi, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 494 i Vendimit

Data 17.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë në këshillin e Bashkisë Tiranë të depozituara nga Partia "Aleanca Kuq e Zi" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019